

VENDIM
Nr.39, datë 22.1.2004

PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, DETYRAT DHE TË DREJTAT E KOMISIONIT TË SHËRBIMIT ALTERNATIV

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9047, datë 10.7.2003 "Për shërbimin ushtarak në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Shërbimit Alternativ pranë Ministrisë së Mbrojtjes, i cili të kryesohet nga zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe të ketë në përbërje:

- | | |
|--|---------|
| - dy përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes | anëtarë |
| - një përfaqësues nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale | anëtar |
| - një përfaqësues nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit | anëtar |
| - një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë | anëtar |
| - një përfaqësues nga Komiteti Shtetëror i Kulteve | anëtar |

2. Komisioni i Shërbimit Alternativ të funksionojë si organ kolegjal e vendimmarrës, në mbështetje të ligjit nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

3. Komisioni i Shërbimit Alternativ mbledhet, si rregull, një herë në 3 muaj, sipas njoftimit të Kryetarit të Komisionit. Njoftimi përmban rendin e ditës dhe materialet që do të diskutohen në mbledhje. Ai u dërgohet anëtarëve të Komisionit të paktën 7 ditë përpara datës së caktuar për mbledhje.

4. Komisioni i Shërbimit Alternativ i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e thjeshtë e anëtarëve. Për shkaqe objektive, mbledhjet e Komisionit mund të shtyhen, por jo më vonë se 15 ditë nga data e caktuar.

5. Komisioni i Shërbimit Alternativ ka këto detyra:

a) Shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga qendrat e rekrutim-mobilizimit për kryerjen e shërbimit alternativ të shtetasit.

b) Vendos për kryerjen e shërbimit alternativ nga shtetasi që ka bërë kërkesën.

c) Vendos mospranimin e kërkesës së shtetasit për kryerjen e shërbimit alternativ dhe ia kthen praktikën qendrave të rekrutim-mobilizimit për kryerjen e shërbimit të detyrueshëm ushtarak aktiv në Forcat e Armatosura, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë rast, Komisioni i Shërbimit Alternativ duhet të bëjë arsyetimin përkatës për mospranimin e kërkesës.

ç) Shqyrton ankesën e bërë me shkrim nga shtetasi për vendimin e Komisionit dhe merr vendimin përfundimtar. Shtetasi ka të drejtë ta bëjë këtë ankesë brenda 30 ditëve nga dhënia e vendimit.

d) Në çdo rast që e gjykon të nevojshme, mund të kërkojë të dhëna të tjera nga shtetasi që ka bërë kërkesën për kryerjen e shërbimit alternativ, si dhe nga specialistë të fushave të ndryshme, që kanë lidhje me veprimtarinë dhe objektin e punës së këtij Komisioni.

6. Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar dhe për sekretarin e Komisionit të Shërbimit Alternativ, të jetë 5000 (pesë mijë) lekë.

7. Efektet financiare të përballohen nga buxhetet vjetore të ministrive dhe institucioneve të përfaqësuar në Komisionin e Shërbimit Alternativ.

8. Ngarkohen ministrinë dhe institucionet e përmendura në pikën 1 për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano